

SEE
MORE
Media Observatory Report

Numri i dytë i MORE përmban:

- 1. Vizitën e parë të Mitsotakis-it në Shqipëri:** deklarata e pavend, ndjesa e moti i keq
Faqe 4
- 2. Dendias edhe një herë në Tiranë:** Turqia si faktori i tretë në marrëdhëniet greko-shqiptare
Faqe 11
- 3. Vizita historike e Mitsotakis-it në minoritet në Shqipëri:** minoriteti grek si një "urë miqësie"
Faqe 17

#02. Korrik 2023

ZBATUAR NGA

MUNDËSUAR NGA

MBI

SEE MORE



HYRJE: Raporti i Observatorit të Medias (MORE)

Numri i dytë i MORE botohet në një periudhë tensionesh dypalëshe të ripërtërira pas arrestimit dhe ndalimit të anëtarit të mintoritetit etnik Grek dhe kryetarit të zgjedhur të Bashkisë Himarë, Fredi Beleri, majin e kaluar. Kjo krizë e re, e cila mbetet e pazgjidhur dhe kërcënon të prishë përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshe, do të analizohet në raportin e tretë të MORE.

Ky raport aktual është dëshmi e paqëndrueshmërisë së marrëdhënieve dypalëshe. Kjo sepse periudha e mbuluar (dhjetor 2022 – shkurt 2023), vizitat e zhvilluara në Shqipëri në atë periudhë nga kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis dhe ministri i Jashtëm Nikos Dendias, dhe puna mediatike që monitoruam, të gjitha tregojnë vullnetin e dy qeverive për të hapur një faqe të re në marrëdhëniet dypalëshe.

Në atë kohë, të dy qeveritë dukej se ishin në të njëjtën gjatësi vale, ku vetëm mediat, me raportimet e tyre shpesh stereotipike apo paragjyquese, bëheshin pengesë për përmirësimin e shpejtë të marrëdhënieve dypalëshe. Disa muaj më vonë, klima politike duket më pak e favorshme.

Në raportin e ardhshëm të MORE do të ketë më shumë rreth fakteve se si gjërat erdhën drejt përkeqësimit. Tani për tani, le të ndalemi te vizitat e nivelit të lartë në Shqipëri dhe se si mediat e të dyja palëve nuk arritën të kuptojnë atmosferën politike mes dy qeverive. Siç do të shohim në këtë raport, në kontrast me qëndrimet e lidërshipeve politike, media greke prirej të mbështetej në stereotipa për të diskredituar lidërshipin e Shqipërisë, në vend që të përpiqej të kuptonte tendencat komplekse sociopolitike të kombit fqinj. Nga ana e tyre, mediat shqiptare shpesh publikonin analiza të paargumentuara të 'qëllimeve reale' të palës tjetër, duke e përshkruar Greqinë si një "shantazhuese" me kontroll të plotë mbi perspektivat e Shqipërisë në BE dhe prosperitetin e mëvonshëm.

Analiza jonë synon të ofrojë edhe një herë elementë për të reflektuar rreth faktit që mediat, në të dy vendet, - të paafta për të parë pyllin për shkak të pemëve, - riciklojnë ide të gabuara dhe në fund të fundit, dështojnë në pasqyrimin e realiteteve të reja, si në marrëdhëniet dypalëshe ashtu edhe në kontekstin më të gjerë të rajonit të Ballkanit dhe BE-së.

02.



SEE MORE

Në brendësi të ngjarjeve

Raporti i dytë i MORE është fryt i monitorimit të medias nga periudha dhjetor 2022 deri në shkurt 2023. Kemi përzgjedhur tri histori kryesore për t'i analizuar nga kjo periudhë.

Për çdo ngjarje, Raporti i Observatorit të Medias (MORE) ofron:

- a. një historik të shkurtër
- b. një analizë të shkurtër cilësore të disa lajmeve të caktuara mediatike (shembuj ngacmues, tituj lajmesh, narrativa)
- c. një raport të ngjarjeve reale të raportuara në mënyrë jokorrekte;
- d. një vlerësim të rëndësisë politike të zgjedhjeve të mësipërme mediatike dhe efektit të tyre në perceptimet publike, por, më së shumti, mundësive që media humbi për të luajtur një rol konstruktiv në krijimin e një debati politik më të shëndetshëm;
- e. konkluzione kryesore përballë ndikimit politik të mbulimit mediatik.



Ky nr. i dytë i MORE fokusohet në:

1. **Vizitën e parë të Mitsotakis-it në Shqipëri:** deklarata e pavend, ndjesa e moti i keq
[Shkoni në faqen 4](#)
2. **Dendias edhe një herë në Tiranë:** Turqia si faktori i tretë në marrëdhëniet greko-shqiptare
[Shkoni në faqen 11](#)
3. **Vizita historike e Mitsotakis-it në minoritetet në Shqipëri:** minoriteti grek si një "urë miqësie"
[Shkoni në faqen 17](#)

1. ÇËSHITJA

Vizita e parë e Mitsotakis-it në Shqipëri:

Deklarata e pavend, ndjesa e moti i keq



Samiti BE-Ballkani Perëndimor - 2022
Fotografia familjare: Tiranë, Shqipëri, Dhj. 6, 2022
©Bashkimi Evropian. [Credit Link](#)

1.1. HISTORIK I SHKURTËR

Ishte vizita e parë e një kryeministri grek në Tiranë në 13 vjet, dhe u zhvillua në kuadër të një [Samiti BE-Ballkani Perëndimor](#), vizita e parë e tillë e zhvilluar në një vend kandidat. Rastësisht, vizita e fundit e një kryeministri grek në kryeqytetin shqiptar ishte në 2009-ën, kur një ditë më parë Shqipëria paraqiti aplikimin e saj për anëtarësim në BE. Prania e Kyriakos Mitsotakis-it në Tiranë kishte synim t'i shërbente [një qëllimi të dyfishtë](#): të nxiste perspektivat evropiane të Shqipërisë dhe të promovonte përmirësimin e mëtejshëm në marrëdhëniet dypalëshe.

Megjithatë, vizita u "la në hije" nga një intervistë e publikuar në [Euractiv](#) në të njëjtën ditë, në të cilën kryeministri shqiptar, Edi Rama, u shfaq duke thënë se Greqia e kishte "mashtuar BE-në" për shumë vite para dhe pas hyrjes në BE. Rama [i kërkoi falje](#) homologut të tij për komentin e bërë gjatë takimit dypalësh. Moti i keq e pengoi Kyriakos Mitsotakis-in të vizitonte fshatrat ku jetojnë anëtarë të minoritetit grek.

Këto çështje nxitën SYRIZA-n, partinë kryesore opozitare greke, e cila akuzoi qeverinë për "menaxhim të rrezikshëm të komunikimit" në politikën e jashtme greke.

1.2. MEDIAT GREKE

Një vizitë “e mjegullt”: Vizita e kryeministrit grek në Tiranë dhe prania e tij në Samitin BE-Ballkani Perëndimor mund të ketë marrë mbulim mediatik të gjerë për tri ditë radhazi, por qasja ndryshonte në varësi të linjës editoriale të redaksive të veçanta.

Për shembull, gazetat proqeveritare vunë theksin te çështja e lënë pezull e kufijve detarë, si dhe tek kërkimi i faljes nga ana e Ramës ndaj Mitsotakis-it për deklaratat e tij në Euractiv. Mediat nacionaliste folën për fyerjen e bërë nga Rama dhe theksuan marrëdhënien e tij të ngushtë me presidentin turk. Media që mban lidhje me SYRIZA-n ([Avgj](#)) pretendoi se vizita ishte një **“fiasko diplomatike”** dhe madje vuri në dyshim nëse kushtet e këqija të motit ishin vërtet arsyeja që Mitsotakis shtyu vizitën e tij në fshatrat e pakicës etnike greke.

Një shembull tjetër është titulli i faqes së parë të **Ta Nea**: **“Kërkesa e faljes së Ramës** dhe rruga për në Hagë”. Titujt e tjerë tregues ishin: “Shqiptarët po **tallen me ne**” (**Dimokratia**), **“Shqiptarët na pështyjnë dhe ne themi se po bie shi”** (**Estia**), “Rama bllokoi Mitsotakis-in: **Turqit po përpiqen të godasin** marrëdhëniet midis Athinës dhe Tiranës në çdo mënyrë të mundshme” (**Kontra**).

Kathimerini (e qendrës së djathtë) zbuloi se: “Pavarësisht marrëveshjes politike (...), duket se kompromisi [d.m.th., dokumenti ligjor që do t’ia referojë çështjen GJND-së] është ende larg miratimit nga ana e Shqipërisë. Athina i kërkoi Uashingtonit dhe Berlinit që të ndërmjetësojnë në Tiranë në muajt e fundit, për të avancuar çështjen. Megjithatë, rezultatet kanë qenë më pak se frytdhënëse, pa u zhvilluar asnjë takim në nivel teknik”.

Mediat Greke

Vizita e parë e Mitsotakis-it në Shqipëri

dhjetor 2022

FJALË “TOKSIKE”

“...**fiasko diplomatike**”

AVGI (E QENDRËS)

“**Turqit po përpiqen të godasin** marrëdhëniet midis Athinës dhe Tiranës në çdo mënyrë të mundshme”

KONTRA (E QENDRËS)

“Shqiptarët po **tallen me ne**”

DIMOKRATIA (E QENDRËS)


“Shqiptarët na pështyjnë dhe ne themi se po bie shi”

ESTIA (E QENDRËS)

Dimokratia (e së djathtës) theksoi në editorialin e saj se: “Z. Rama po kërkon të poshtërojë si kryeministrin Mitsotakis, ashtu edhe vendin tonë dhe këtë turpërim e bën sepse është i bindur se nuk do të ketë asnjë pasojë për ato që tha”, duke shtuar se: “Nuk është e mundur të merret seriozisht në konsideratë kandidatura e Shqipërisë në BE. Kjo është një shaka e keqe. Shqipëria është një vend që shkel sistematikisht të drejtat e njeriut dhe shtyp brutalisht pakicën kombëtare greke”.

Mediat greke

Vizita e parë e Mitsotakis-it në Shqipëri dhjetor 2022



ΑΟΖ: Νέα προσπάθεια για συνυποσχετικό με την Αλβανία

Το νέο διπλωματικό φιάσκο στην Αλβανία
 Ούτρε Χάγη για την ΑΟΖ ούτε επίσκεψη στα μονοκλιμάκια. Η απεικονιστική «συγγνώμη» Ράμα και η πλειόουσιτη Χειμάρρα σελίδα 7



ΜΠΛΟΚΟ ΑΠΟ ΡΑΜΑ ΣΤΟΝ ΜΗΤΣΟΤΑΚΗ
 Οι Αλβανοί έβαλαν βέτο ακυρώνοντας την επίσκεψη του πρωθυπουργού στο κλιμάκι με κορυφή ελληνική μεσοπέλαγα
 Οι Τούρκοι σπινραζούν με κάθε τρόπο να τορπιλίσουν τις σχέσεις ανάμεσα στην Αθήνα και τη Τίρانا



Μας «πτύουν» οι Άλβανοί, και έμεις λέμε ότι βρέχει...
 του Εύθ. Π. Πέτρον

1.3. MEDIAT SHQIPTARE

Optimizëm për përcaktimin e kufijve të zonave detare: Prania e kryeministrit grek në Tiranë u mbulua gjerësisht në media, por fokusi kryesor ishte te çështja e zonave detare. Raportimi i përgjithshëm ishte pozitiv, duke lënë hapësirë për 'optimizmin' **e shprehur nga kryeministri grek** se do t'i gjendej një zgjidhje çështjes. Megjithatë, nuk kishte konsensus se cila palë është përgjegjëse për çuarjen përpara të procesit.

Shqiptarja.com (proqeveritare) shkruante: "Kryeministri grek në Tiranë: Optimist se së bashku me qeverinë shqiptare do të gjendet një zgjidhje për çështjen e detit". **Syri.net** (pro opozitës), duke folur ende për 'optimizëm', fokusohet kryesisht në përgjegjësitë e palës shqiptare.

Mediat shqiptare

Vizita e parë e Mitsotakis-it në Shqipëri

dhjetor 2022



1.4. QARTËSIM I SITUATËS MBI FAKTE

a. Intervista e Ramës me Euractiv

Çfarë u tha në të vërtetë: Intervista në Euractiv u publikua ditën e Samitit. Në [versionin anglisht](#) të intervistës së tij, Rama foli për “nevojën për të çuar përpara reformat për të garantuar autenticitetin e procesit të zgjerimit”. Ai tha konkretisht: “Nuk duhet të harrojmë se procesi i integritetit është një proces individual, i bazuar në merita. Ne duhet të përmbushim standardet e kriteret e detyrave të shtëpisë dhe nuk është një provim për të mashtruar (...).” Ai shtoi se është thelbësore të kemi institucione funksionale dhe të mos “mashtrojmë” shumë siç bënë disa vende fqinje në të kaluarën. Kur iu kërkua të përmendte emra, Rama tha: “Greqia”.

Megjithatë, në [versionin grek](#) thuhej: “Kryeministri shqiptar Edi Rama... dha një intervistë ekskluzive për Euractiv, e cila përmbante nënkuptime kundër Athinës. Ai pak a shumë deklaroi se Greqia 'mashtroi' për t'u anëtarësuar në BE. Konkretisht, versioni grek e ka përkthyer pikën kyçe të deklaratave të tij kështu: “Dhe për shkak se është për të mirën tonë”, tha ai, “ne duhet të kemi institucione funksionale”. “Jo siç bënë disa vende në të kaluarën, si një vend fqinj, Greqia, për shembull, që mashtronte shumë. Mori para nga Evropa, kaloi një periudhë lulëzimi dhe më pas përfundoi shumë keq”, theksoi kryeministri shqiptar.

Shtrembërimi i realitetit: Pra, duket se polemika u provokua nga përkthimi qartësisht shtrembërues në greqisht i tekstit origjinal. Teksti origjinal fjalë për fjalë i intervistës së plotë të Ramës nuk gjendet në faqen e Euractiv. Megjithatë, duket qartë se, diku midis dy versioneve, tekstit të botuar iu dha një tjetër kuptim që, sigurisht, ishte jomiqësor ndaj Greqisë.



Foto P7GPMFD ©iLixe48 - Envato Elements (përshtatje)

Kjo nuk do të thotë se deklaratat e Edi Ramës nuk ishin pavend, por përkthimi shtrembërues çoi në një sërë lajmesh, shkrimesh dhe titujsh në mediat greke që fokusoheshin në fyerjen e supozuar.

Ndaj mediat greke theksuan se Greqia kishte arsye të mira për të qenë dyshuese ndaj Ramës dhe veçanërisht ndaj rolit të tij në çështjen e kufijve detarë; këto analiza sugjeruan, si pasojë, se Greqia mund të bllokonte procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Pas dyerve të mbyllura: Duke lexuar [deklarimet publike](#) të dy kryeministrave gjatë takimit të tyre dypalësh, duket se është diskutuar për intervistën e zotit Rama, por se ndjesa e tij (ku [raportohet të ketë thënë](#): “Kjo nuk nënkuptonte kurrë Greqinë bashkëkohore”) u prit mirë nga delegacioni grek dhe nuk e la në hije thelbin e bisedimeve.

1.4. QARTËSIM I SITUATËS MBI FAKTE

b. Shtyrja e vizitës së Mitsotakis-it në fshatrat e minoritetit grek

Çfarë ndodhi në të vërtetë: Kyriakos Mitsotakis fillimisht ishte planifikuar të vizitonte Himarën, Livadhin dhe Derviçanin më 8 dhjetor, pas vizitës së tij në Tiranë, por vizita u shty për shkak të motit të keq. Sipas burimeve qeveritare, zyra e tij ishte informuar një mëngjes më parë nga autoritetet greke se në Himarë parashikohej mjegull në orët e para të 8 dhjetorit. Ata mendonin se helikopteri nuk do të mund ta kryente fluturimin. Të njëjtat burime thanë se Mitsotakis ishte planifikuar të merrte pjesë në një takim të partisë Nea Dimokratia atë mbrëmje në Athinë dhe si rezultat kishte zgjedhur të udhëtonte me helikopter.

Polemika politike: Duket se intervista e Ramës dhe shtyrja e vizitës së Mitsotakis-it në fshatrat e minoritetit grek i lejuan SYRIZA-s të minimizonte rëndësinë politike të vizitës së kryeministrit grek në Shqipëri, edhe para se të kishte ndodhur. Më 6 dhjetor, një ditë përpara se Mitsotakis të vizitonte Tiranën, Avgi, gazeta e SYRIZA-s shkruante për “akrobacitë parazgjedhore të Mitsotakis-it me pakicën”, duke e akuzuar atë se po përpiqej të fitonte më shumë vota nga e djathta e spektrit politik përpara zgjedhjeve parlamentare.

Imagjinaria kundrejt realitetit: Më 7 dhjetor, Estia (edjathtë) shkruante: “Z.Rama, nuk garanton dot sigurinë e kryeministrit dhe ëndërron akoma për BE-në?”, ndërsa Ta Nea vuri në pikëpyetje nëse ka pasur “një paralajmërim për një provokim të planifikuar nga ultranacionalistët shqiptarë? Një incident i mundshëm me çamët mund të jetë një shpjegim,” tha ajo. Vizita e mëvonshme e kryeministrit grek në jugun shqiptar zbuloi se një raportim i tillë ishte spekulim i pastër që shërbeu vetëm për të përforcuar stereotipat që ekzistonin për Shqipërinë.

Shtyrja e vizitës së Mitsotakis-it në fshatrat e minoritetit grek



Foto P7GPMFD ©iLixe48 - Envato Elements (përshtatje)

Në mediat shqiptare, historiani Arben Llalla tha për [Euronews Albania](#) se vizita e kryeministrit grek në Himarë ishte shtyrë pas kërkesës së kryeministrit shqiptar, pasi Mitsotakis do të shoqërohej në pikën kufitare të Kakavijës nga përfaqësues të ekstremit të djathtë, të cilët nuk ishin të mirëpritur në Shqipëri. Sërish nuk kishte asnjë provë për ndonjë plan të tillë nga ana e kryeministrit grek dhe raportimi shërbeu vetëm për të përforcuar stereotipat ekzistues në median shqiptare.

Në përgjithësi, pavarësisht thashethemeve dhe dezinformatave për të kundërtën, ishin kushtet e këqija të motit që e penguan kryeministrin grek të vizitonte fshatrat ku jetojnë grekët etnikë. Më së fundi, vizita e riplanifikuar u ndërmor nga Mitsotakis dhe Rama vetëm pak ditë më vonë, më 22 dhjetor.

1.5. RËNDËSIA POLITIKE

Marrëdhënie të mëtejshme “helmuese”: Shumica e artikujve dhe shkrimeve të shtypit grek zgjodhën më mirë të nënvizonin deklaratat pavend të kryeministrit shqiptar, sesa atmosferën miqësore që kishin të dy zyrtarët gjatë gjithë vizitës. Për shembull, një koment në Ta Nea, ndonëse theksonte se deklarata e Ramës është

interpretuar gabim, përsëri vërente se: “vetë fjala “mashtrim” është fyese dhe zbulon vrazhdësinë e kryeministrit shqiptar, veçanërisht si mikpritës i Samitit BE-Ballkani Perëndimor”.

Një tjetër shkrim në [Kathimerini](#) me titullin: Kërkimi i besimit shqiptar (duke përdorur fjalën shqipe 'besa') citonte se Greqia nuk duhet t'i besojë liderit shqiptar, sepse "përvoja tridhjetë vjeçare na ka mësuar se problemet me Shqipërinë (...) në përgjithësi shfaqen në momentin e zbatimit (të marrëveshjeve). Përvoja jonë me disa politikanë na mëson se ata harrojnë angazhimet e tyre. Ata kërkojnë pretekste për t'i anuluar, ose në rastin më të mirë për t'i shtyrë ato”.

Mendime të tilla jo vetëm që nuk arritën të evidentonin rezultatin pozitiv të vizitës së kryeministrit grek në Tiranë, por, në fakt, shtuan stereotipizimin dhe mosbesimin ndaj Shqipërisë, veçanërisht nëpërmjet komenteve poshtëruese dhe gjuhës së përdorur nga lideri i saj.

S'të lënë pemët të shohësh pyllin: Me përjashtim të një artikulli në [Kathimerini](#), i cili vuri në dukje rëndësinë e Samitit të Tiranës për t'i dhënë një shtysë të re procesit të zgjerimit, mediat e të dy vendeve, shqiptare dhe ato greke, u fiksuan edhe një herë me kokëfortësi, në çështjen e përcaktimit të kufirit të Zonave Ekskluzive Ekonomike. Si përfundim, ato nuk arritën të trajtonin përfitimet që mund të sillte hyrja e Shqipërisë në BE, qoftë sa u përket marrëdhënieve dypalëshe, ashtu edhe për hapësirën e gjerë ballkanike.

Është gjithashtu e qartë, veçanërisht pas fillimit të negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë me BE-në në korrik 2022, se liderit shqiptar në Athinë dhe Tiranë kanë qenë të gatshëm për t'i vendosur marrëdhëniet dypalëshe në një rrugë të re. Ky qëndrim pozitiv ka munguar gati krejtësisht në analizat e mediave të të dy palëve.

Key Takeaways

1.6. KONKLUZIONE KRYESORE

- ↳ Me fillimin e negociatave të Tiranës me BE-në, liderit shqiptar në të dy vendet intensifikuan përpjekjet e tyre për të përmirësuar marrëdhëniet dypalëshe dhe për të zgjidhur gradualisht çështjet dypalëshe. Vizita e Mitsotakis-it në Tiranë në fillim të dhjetorit, e para e një kryeministri grek në Shqipëri në 13 vjet, ishte pjesë e këtyre përpjekjeve.
- ↳ Edi Rama bëri deklaratë pavend, të cilat u interpretuan gabim nga mediat greke dhe partitë opozitare dhe për të cilat kërkoi falje. Udhëheqja politike greke i qëndroi tezës së vet, duke theksuar zgjedhjen e saj strategjike për të mbështetur procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.
- ↳ Megjithatë, analizat tepër të cekëta dhe nënçmuese në shtypin grek vazhdojnë të nxisin mosbesimin ndaj palës shqiptare dhe të injorojnë progresin e bërë nga shoqëria shqiptare dhe politika.
- ↳ Mediat nga të dyja palët vazhdojnë të fokusohen me këmbëngulje në përcaktimin e kufijve të zonave detare. Ndërsa çështja duhet të zgjidhet qartë, – edhe përpara përfundimit të negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, për të parandaluar shfrytëzimin politik të saj nga faktorët e të dyja palëve, – rruga ligjore e rënë dakord nga të dyja palët është mënyra më e përshtatshme për ta bërë këtë.

2. ÇËSHTJA

Dendias edhe një herë në Tiranë:

Turqia si faktor i tretë në marrëdhëniet Greqi-Shqipëri



MPJ Dendias takon homologen e tij Shqiptare Olta Xhaçka në Tiranë, Dhj. 21, 2022. flickr.com, Yurajev Egor, Epskov, Creative Commons (CC BY-SA 2.0) License. [CreditLink](#).

2.1. HISTORIK I SHKURTËR

Ministri i Jashtëm grek Nikos Dendias vizitoi Tiranën në mes të dhjetorit në kuadër të një mini-turneu në Ballkanin Perëndimor. Ishte [hera e tretë](#) që Dendias vizitonte Tiranën, ku u takua me homologen e tij Olta Xhaçka dhe kryeministrin Edi Rama. Deklaratat publike të të dy ministrave të Jashtëm pasqyruan një atmosferë shumë pozitive dhe konferenca e tyre për shtyp përfundoi pa incidente, ndryshe [nga konferenca e tyre për shtyp në maj 2022](#), e cila u la në hije nga një deklaratë për çamët e bërë nga Xhaçka.

Sipas mediave greke, e vetmja qime ne qull ishte [blerja](#) nga Shqipëria e tre dronëve turq “Bajraktar” një ditë para mbërritjes së Dendias-it në Tiranë dhe dy ditë para vizitës së kryeministrit grek në jug të Shqipërisë (shih më poshtë për më shumë për këtë). Ish-kryeministri i Shqipërisë Sali Berisha, i intervistuar për Euractiv në të njëjtën ditë, përforcoi besimin mbizotërues në Greqi se Ankaraja qëndronte pas anulimit të marrëveshjes së kufijve detarë të vitit 2009 midis Athinës dhe Tiranës.

2.2. MEDIAT GREKE

Parehati për dronët “Bayraktar”: Vizita u pasqyrua mirë në shtyp. Megjithatë, me përjashtim të disa referencave për atë që në të vërtetë thahet në dy ministrat e Jashtëm, shumica e lajmeve theksuan pakënaqësinë e Dendias-it me Ramën që kishte kontraktuar për të blerë tre dronë “Bayraktar” nga një kompani turke. Në përfundim të vizitës së tij, [Dendias-i tha](#) se Shqipëria kishte bërë një zgjedhje kyçe për t'u anëtarësuar në BE dhe se Greqia e mbështet me entuziazëm këtë rrugë. Megjithatë, vazhdoi ai, kjo do të thotë se vendi duhet të vendosë "një sërë kriteresh" që i shërbejnë narrativës bazë të BE-së.

Avgi (e majtë) e pa si **shantazh indirekt** deklaratën e Dendias-it: “Shqipëria (duhet të zgjedhë të jetë) ose me BE-në ose me Turqinë”, ndërsa **Eleftheros Typos** (e djathtë) shkruante: “**Insi-nuata** e Dendias-it drejtuar Tiranës për dronët turq”. [Kathimerini](#) shkruante se: “Dendias ka dërguar një **mesazh** shumë të matur, por **të qartë** në lidhje me perspektivat evropiane të Shqipërisë dhe ndikimin e rolit minus të luajtur në Ballkanin Perëndimor nga **aktorë të tretë** me axhendë revizioniste, **si Turqia**”.

Mediat greke

Dendias edhe një herë në Tiranë
dhjetor 2022

Απάντηση
Δένδια στον Ράμα
για την Τουρκία



Η ΑΥΓΗ



Η με την Ε.Ε., ή με την Τουρκία η Αλβανία

Εμφανιστική επίθεση Δένδια στον Ράμα μέσα στα Τίρανα μία μέρα πριν από την επίσκεψη Μπιτσότση στα μεμονωτικά χωριά της Αλβανίας

Αιχμές Δένδια προς Τίρανα για τα τουρκικά drones



Αιχμές Δένδια προς Τίρανα για τα τουρκικά drones

Απάντηση Δένδια στον Ράμα για Τουρκία, Bayraktar

Επίσκεψη στα Τίρανα

Εφάρσον η Αλβανία έχει κάνει την επιλογή να καταστεί μέλος της Ε.Ε., θα πρέπει να λάβει και τις ανάλογες αποφάσεις, είτε χέσει από τα Τίρανα ο υπουργός Εξωτερικών Νίκος Δένδιας, λίγο μετά τις δηλώσεις του πρωθυπουργού Εντι Ράμα πως γιόβει υπερήφανος διότι η χώρα του είναι «στην ίδια πλευρά» με την Τουρκία. Ο κ. Ράμα, μετά την υπογραφή για προμήθεια τριών UAV τύπου Bayraktar, περιέγραψε την Τουρκία ως «στρατηγικό στήριχο της χώρας του» λέγοντας ότι «το εισαγόμενο δεν είναι ορκετό» για τον «φιλό του κ. Ερντογάν». Σελ. 4

2.3. MEDIAT SHQIPTARE

Përcaktimi i EEZ-së mbetet prioritet: Mediat i dhanë prioritet përcaktimit të zonave detare. **Gazeta Panorama** (pro opozitës) vuri në dukje se Xhaçka iu drejtua në mënyrë miqësore ministrit të Jashtëm grek. "I dashur Niko" – *Ministri i Jashtëm flet për diskutimet mbi marrëveshjen detare me Greqinë: Kërkojmë një kompromis për referimin në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë*", shkruante ajo. **Voice of America** (neutrale) i dha hapësirë çështjes së zonave detare, me fokus tek Dendias që theksonte rëndësinë e respektimit të ligjeve ndërkombëtare si bazë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dypalëshe.

Marrëveshja "Bajraktar" 'shqetëson' Greqinë: Mediat raportuan edhe pakënaqësinë e Dendias-it për blerjen e "bajraktarëve" nga Shqipëria. **Liberale.al** (pro opozitës) raporton se "armatosja e Shqipërisë me dronë nga Turqia tërbon Greqinë, Dendias: "Janë shfaqur forcat revizioniste". Nga ana e saj, **ABC News** (proqeveritare) raportoi: "Media greke: Dendias 'gozhdon' Turqinë për depërtimin në Shqipëri, kjo bie ndesh me 'acquis evropiane'".

Panorama ONLINE

Çështja e detit ka qenë një nga temat e rëndësishme që është diskutuar në takimin e mbajtur të mërkurën e 21 dhjetorit mes ministres së Jashtëm Olta Xhaçka dhe homologut të saj grek Nikos Dendias.



Mediat shqiptare

Dendias edhe një herë në Tiranë
dhjetor 2022



VOA
Ministri i jashtëm grek viziton Tiranën, sërish mbi shenjimim e zonave detare



2.4. QARTËSIM I SITUATËS MBI FAKTE

Mbi deklaratën e Berishës: Vizita e Dendias-it në Tiranë përkoi me [një deklaratë të bërë në EURACTIV](#) nga ish-kryeministri Sali Berisha, i cili thuhet se deklaroi që Turqia kishte “ndërrhyrë” për të anuluar marrëveshjen detare të vitit 2009 Greqi-Shqipëri. Deklarata e tij u citua nga një sërë artikujsh në shtypin grek. **Political** (e djathtë) shkruante: “Roli i Edi Ramës dhe ‘bomba’ e Berishës”, ndërsa **Estia** (e djathtë) në një shkrim të titulluar “Nacionalizmi i ri romantik” theksonte se Berisha po fliste gjysmë të vërteta duke lënë jashtë marrëdhënien e tij me Turqinë; gazeta arriti në përfundimin se rrugëtimi i Shqipërisë në BE kalon përmes Athinës, jo Ankarasë.

Çfarë është thënë në të vërtetë: Berisha në intervistën e tij iu referua marrëveshjes dypalëshe të arritur në vitin 2009 për përcaktimin e kufijve të zonave detare. Ai tha se Partia Socialiste, në atë kohë në opozitë, e drejtuar nga kryeministri aktual Rama, iu drejtua Gjykatës Kushtetuese përpara se marrëveshja të ratifikohej nga të dyja vendet. Pastaj ai tha: “Greqia e nënshkroi me gjashtë milje detare ujëra territoriale na favor të saj. Edi Rama ishte ai që çoi marrëveshjen në Gjykatën Kushtetuese. Turqia nuk u interesua kurrë për atë marrëveshje dhe bëri një ndërrhyrje të fortë”.

E hapur për interpretime: Vlen të përmendet se për intervistën nuk u sigurua asnjë video incizim dhe Euractiv nuk ofroi as tekst në gjuhën shqipe. Deklarata e Berishës, e përkthyer në anglisht dhe [Greqisht](#) nga Euractiv, duket e hapur për interpretime të ndryshme. Një tjetër pikë është se intervistuesi nuk e pyeti Berishën se çfarë do të thoshte me “ndërrhyrje të fortë”, veçanërisht pasi thuhet se ai kishte deklaruar që “Turqia nuk ishte kurrë e interesuar”.



Intervista e Ramës
me Euractiv

Foto P7GPMFD ©iLixe48 - Envato Elements (përshtatje)

Nuk ishte hera e parë që raportimi në gjuhën greke i Euractiv kishte dëmtuar efektivisht një vizitë zyrtare greke në Tiranë; e njëjta gjë ndodhi me përkthimin keqinterpretues të intervistës së Ramës në ditën e vizitës së Mitsotakis-it. Megjithatë, media greke nuk e vuri kurrë në dyshim deklaratën e paqartë dhe vendosi ta ribotonte atë, thjesht për të përforcuar një narrativë të zakonshme në Greqi se Ankaraja qëndronte pas anulimit të marrëveshjes detare të vitit 2009 ([për më shumë, shih MORE nr. 1](#)). Gjithashtu, nuk ishte hera e parë që Berisha e pretendonte këtë gjë. Në fakt, ai [kishte fajësuar](#) edhe një palë të tretë për anulimin e marrëveshjes së vitit 2009 në vitin 2016, ndonëse nuk përmendi emrin e palës në atë rast. Asnjë media, në asnjë rast, nuk u përpoq të kërkonte apo t'i referohej ndonjë deklaratë të mëparshme, apo të verifikonte vërtetësinë e saj.

2.5. H RËNDËSIA POLITIKE

Bjери pragut që të dëgjojë dera: Artikujt e mediave greke mbi vizitën e tretë të shefit të diplomacisë greke në Tiranë u fokusuan më shumë në mesazhet indirekte të Dendias-it për Turqinë. Roli i Ankarasë në Ballkan. Pika kryesore që Dendias donte të evidentonte në konferencën për shtyp me homologun e tij ishte kur theksoi praninë e forcave revizioniste në rajon. Ishte gjithashtu zgjedhja e tij të shprehte pakënaqësinë lidhur me blerjen e dronëve turq nga Shqipëria në një deklaratë të veçantë. Madje ai paralajmëroi me delikatesë Tiranën se duhet të zgjedhë aleatët dhe miqtë e saj kur theksoi se Shqipëria duhet të vendosë "një sërë kriteresh" që i shërbejnë narrativës bazë të BE-së.

Më pas, mediat greke i dhanë më shumë rëndësi marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Turqisë, duke i lidhur shkrimet e tyre me intervistën e Berishës dhe duke përforcuar kështu besimin e përhapur në Greqi se një marrëdhënie e veçantë mes Ankarasë dhe Tiranës synon Athinën.

Megjithatë, një shkrim i Mero Baze për gazetën [Tema](#) vinte në dukje se me intervistën e tij, Berisha në thelb po kërkonte të "shfrytëzonte" politikisht këtë perceptim në Greqi. Sipas Bazes, Berisha besonte se argumenti i tij mund të nxiste GJND-në që ta shihte anulimin si rezultat i një ndërhyrjeje turke, duke lënë kështu të paprekur marrëveshjen e tij me Greqinë. Dhe së dyti, Berisha po përpiqej të paraqitej si njeriu i Greqisë në Shqipëri duke identifikuar Ramën me Erdoganin. Baze konkludoi se, për fat të mirë, marrëdhëniet shqiptaro-greke janë në rrugën e konsolidimit të përhershëm.

Të dy ministrat e Jashtëm e theksuan këtë në deklaratën e tyre të përbashkët, duke deklaruar se janë të gatshëm të bëjnë kompromis për përcaktimin e kufijve detarë dhe duke folur për "urat që lidhin dy popujt tanë", duke ju referuar minoritetit grek në Shqipëri dhe komunitetit shqiptar në Greqi. Me përjashtim të referencave sporadike në disa media (**Avgi, Ta Nea**), pjesa më e madhe e titujve dhe artikujve humbën mesazhet e rëndësishme që të dy ministrat donin të përcillnin për të ardhmen e marrëdhënieve dypalëshe dhe të ardhmen evropiane të Shqipërisë.



2.6. KONKLUZIONE KRYESORE

- ↳ Shqipëria dhe Turqia kanë marrëdhënie afatgjatë dhe janë aleatë të NATO-s. Tirana ka të drejtë të ndjekë marrëveshje ushtarake me çdo vend që u shërben interesave të veta kombëtare. Natyrisht, perspektiva e saj evropiane do të gjykohet edhe në përputhje me vendimet përkatëse të BE-së në çështjet e jashtme dhe të mbrojtjes. Në këtë aspekt, ndryshe nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, liderшипet e të cilëve zakonisht kultivojnë ndjenjën antiperëndimore, Shqipëria mbetet plotësisht në linjë me të drejtat dhe detyrimet e saj në NATO/BE.
- ↳ Greqia ka bërë një zgjedhje strategjike, në përputhje edhe me interesin e saj kombëtar, për të mbështetur perspektivën evropiane të Shqipërisë. Për rrjedhojë, në deklaratat e saj publike, liderшипi politik i Greqisë duhet të nxjerrë në pah përfitimet e kësaj perspektive për marrëdhëniet e saj me Tiranën dhe Ballkanin Perëndimor. Marrëdhëniet e mira dhe të ndershme me Shqipërinë nuk kërkojnë që Tirana të zgjedhë mes aleatëve dhe partnerëve. Zyrtarët grekë nuk duhet të minojnë progresin e bërë në marrëdhëniet dypalëshe duke insinuar se marrëdhëniet e Shqipërisë me Turqinë kanë synime kundër Greqisë.
- ↳ Mediat në të dy vendet duhet të jenë më të kujdesshme kur raportojnë për deklaratat e zyrtarëve dhe të kujdesen që absolutisht të mos riprodhojnë narrativa që dëmtojnë marrëdhëniet dypalëshe. Në vend që të fokusohet vetëm në çështjet e pazgjidhura, media mund të nxjerrë në pah çështjet që po hapin rrugën drejt marrëdhënieve më të forta dypalëshe; si, për shembull, çështjet që lidhen me mjedisin, energjinë, ekonominë ose turizmin, të cilat zakonisht ngrihen nga zyrtarët në të dy vendet, por rrallë shfaqen në lajmet e mediave.

3. ÇËSHTJA

Vizita historike e Mitsotakis-it në minoritetin grek në Shqipëri:

Minoriteti grek si “urë miqësie”



Kryeministri Rama dhe homologu i tij, Grek Mitsotakis takohen në Dervicëan, Shqipëri, Dhj. 22, 2022. E drejta e autorit të fotos: AP Burimi: Lapsi.al | [Credit link](#)

3.1. HISTORIK I SHKURTËR

Vetëm pak ditë pas vizitës së tij në Tiranë, Kyriakos Mitsotakis vizitoi më 22 dhjetor [Himarën, Livadhin dhe Dervicëanin](#), ku jetojnë shumë etnikë grekë. Vizita fillimisht ishte planifikuar të zhvillohej më 7 dhjetor, por duhej shtyrë për shkak të motit të keq.

Ishte vizita e parë e një kryeministri grek në zonat e minoritetit etnik grek të Shqipërisë që kur babai i tij i ndjerë, Konstantinos Mitsotakis, udhëtoi atje si kryeministër 31 vjet më parë. Në Himarë, Mitsotakis-i shoqërohej nga fituesi i medaljes së artë olimpikë, me origjinë nga ky qytet, Pirro Dhima, ndërsa në Dervicëan atij iu bashkua Edi Rama. Të dy kryeministrat [deklaruan](#) se minoriteti grek shërben si “një urë e pazëvendësueshme në lidhjen e pazgjidhshme mes dy vendeve tona”. Rama njoftoi se do të restaurojë sheshin në Dervicëan dhe do ta riemërojë atë me emrin e babait të Mitsotakis-it, gjest i cili u theksua në [media](#).

Qëllimi i vizitës së kryeministrit grek ishte i dyfishtë: të fliste me përfaqësuesit e minoritetit grek, të dëgjonte problemet e tyre dhe të deklaronte mbështetjen e Greqisë, si dhe të dërgonte mesazhin se perspektiva evropiane e Shqipërisë do të jetë e mundur vetëm për aq kohë sa Tirana respekton të drejtat e minoritetit etnik grek në Shqipëri.

3.2. MEDIAT GREKE

Flamujt grekë dhe helenizmi ortodoks: Vizita mori një pasqyrim të mirë në shtyp për gati tetë ditë. Shumica e lajmeve e përshkruan vizitën si historike dhe me rëndësi simbolike duke shfaqur edhe fotografi të Mitsotakis-it tek takonte anëtarë të pakicës greke të cilët mbanin flamuj grekë dhe thërrisnin: "Hellas, Hellas!".

Në titujt e tyre, **Kathimerini** (e qendrës së djathtë) dhe **Ta Nea** (e qendrës) zgjodhën ta vendosnin fokusin tek referimi i kryeministrave për minoritetin grek si një "urë miqësie" dhe deklarata e Mitsotakis-it se grekët e Shqipërisë "e ruajtën flakën e helenizmit dhe Ortodoksisë". Disa gazeta, kryesisht të krahut të djathtë (**Eleftheros Typos** dhe **Dimokratia**), zgjodhën të përdorin termin "Epiri i Veriut", një term që shpesh konsiderohet fyes në Shqipëri, në artikujt dhe titujt e tyre.

Por ndjenjat tipike nacionaliste që dominonin pak më tepër në të shkuarën në mediat greke, u rikthyen përsëri. Për shembull, një shkrim i botuar në gazetën e krahut të majtë pro SYRIZA-s **Efsyn** fliste për "politikat represive" kundër pakicës greke në Shqipëri si një "katastrofë kombëtare [për komunitetin etnik grek] që vazhdon që prej fillimit të viteve 1990". Shkrimi përsëriste shumë klishe standarde nacionaliste, antishqiptare dhe irredentiste. Një përmbajtje e tillë mediatike e ashpër antishqiptare mund të haset ende në shtypin grek, por është shumë më pak popullore se në të kaluarën.

Mediat greke

Vizita historike e Mitsotakis-it në minoritetin grek në Shqipëri
dhjetor 2022



3.3. MEDIAT SHQIPTARE

Ton pozitiv, por ka pak irritim: Vizita e kryeministrit grek u pasqyrua gjerësisht me një ton pozitiv në tërësi. Lajmet theksuan dy mesazhet e tij të qarta: respektimin e të drejtave të minoritetit grek dhe mbështetjen për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Megjithatë, nuk kaloi pa u vënë re nga disa media shqiptare që grekët etnikë u shfaqën për të dëgjuar kryeministrin grek duke mbajtur flamuj grekë, ndërsa të tjerë brohorisnin slogane nacionaliste.

[Shqiptarja.com](#) (pro qeverisë) zgjodhi të dalë me titullin: "Mitsotakis viziton minoritetin grek në Shqipëri: Shqipëria duhet të respektojë të drejtat tuaja! Rama: Pakica kombëtare është një urë lidhëse në marrëdhëniet mes dy vendeve tona". Edhe [Ora News](#) (pro opozitës) raportoi pozitivisht për vizitën në Himarë; titulli i saj: "Flamujt grekë në Himarë për kryeministrin Mitsotakis". [A2CNN](#) (neutrale) theksoi deklaratën e kryeministrit grek për të drejtat e minoriteteve me titullin: "Mitsotakis nga Himara: Do të shohim të zbatohen të drejtat e pronave dhe të gjitha të drejtat e minoriteteve" dhe raportoi se kryeministri grek është pritur me entuziazëm nga banorët e Himarës, me muzikë tradicionale, veshje nga Epiri i Veriut dhe flamuj grekë.


Në Himarë dhe Dervişan, edhe pse të dy flamujt valëvitëshin në ndërtesat publike, flamuri grek ishte shumë më i madh, ndoshta për shkak se nuk u bë asnjë ankesë zyrtare, por thjesht u raportua nga disa media pranë opozitës. Ashtu si [Lapsi.al](#), që e kufizoi raportimin e vet me një incident 'protokol-lar' dhe nuk shtjelloi përmbajtjen e thirrjeve.

Duke thënë këtë, është më se e sigurt se mediat greke do të kishin dënuar çdo incident në të cilin anëtarët e pakicës myslimane në Greqi do të valëvitnin flamuj turq gjatë një vizite të një zyrtari turk në fshatrat e tyre, ose do të brohoritnin slogane me përmbajtje të ngjashme, si mosrespektim i sovranitetit grek.

Mediat shqiptare

Vizita historike e Mitsotakis-it në minoritetin grek në Shqipëri

dhjetor 2022



3.4. QARTËSIM I SITUATËS MBI FAKTE Asociacioni i komunave greke

Çfarë u tha në të vërtetë: Në një artikull në [Gazetën Dita](#) (proqeveritare) në fillim të dhjetorit, ish-diplomati Shaban Murati pretendonte se vizita e kryeministrit grek në minoritetin grek kishte për qëllim inaugurimin dhe zyrtarizimin e krijimit të "Asociacionit të Komunave Greke" në Shqipëri.

Çfarë nënkuptohet: Ish-diplomati nxori jashtë kontekstit një nocion kontrovers të përdorur në dialogun Kosovë-Serbi. Një referencë e tillë kuptohet që do të krijonte dyshime te lexuesit për vizitën e Mitsotakis-it dhe synimet e qeverisë greke.

Shtrembërim i realitetit: Nuk ka asnjë deklaratë publike apo dokument zyrtar që detajon ndonjë synim nga ana e ndonjë qeverie greke për të krijuar një Asociacion të komunave greke në Shqipëri. Madje, sipas burimeve diplomatike në Athinë, zyrtarët grekë nuk kanë kërkuar asnjëherë në vitet e fundit, privatisht, formimin e një asociacioni të tillë nga Shqipëria dhe as nuk kanë ndërmend ta bëjnë këtë në të ardhmen. Edhe një herë, pretendimet e pabazuara në median me influencë duket se kanë funksionuar për të minuar përpjekjet për pajtim nga dy qeveritë.



3.5. RËNDËSIA POLITIKE

Një “kapitull” i ri: Kryeministri grek bëri dy vizita me karakter të lartë simbolik në Shqipëri brenda dy javësh, por vetëm një artikull ([Ta Nea](#)) vuri në dukje vullnetin e dy qeverive për të hapur një faqe të re në marrëdhëniet e tyre. Nga kjo vizitë nuk doli asnjë lajm i madh, por nuk mund të shpërfilllet fakti që Rama ishte i pranishëm në pjesën më të madhe të saj. Megjithatë, lajmet në shtypin grek humbën mundësinë për të nënvizuar rëndësinë e paraqitjes së përbashkët të kryeministrave dhe të vetë vizitës, e cila pasqyroi mbi të gjitha vullnetin e fortë të Greqisë për të mbështetur rrugëtimin evropian të Shqipërisë.

Shtypi grek zakonisht flet për problemet e minoritetit grek – në fakt, tenton ta quajë atë “të harruar”, duke lënë të kuptohet se shteti grek nuk bën mjaftueshëm – kur raporton për marrëdhëniet dypalëshe. Raportet e mediave greke shumë rrallë shkojnë përtej fokusit të ngushtë tek ankesat e minoritetit grek për të raportuar progresin e arritur në Shqipëri dhe për të reflektuar mbi të ardhmen e marrëdhënieve dypalëshe kur vendi është në rrugën e duhur për t’u anëtarësuar në BE. Kjo ka qenë një tjetër mundësi e humbur.

Përsëri mbeten shumë sfida: Në një shkrim të botuar në [Gazeta Panorama](#) (e opozitës), ish-ministri i Jashtëm shqiptar Ditmir Bushati theksoi se, pavarësisht nga ajo që tha Mitsotakis gjatë vizitës së tij në Himarë, qyteti “nuk është një bashki e minoritetit grek” dhe se deklaratat e kryeministrit grek për minoritetin grek nuk pasqyrojnë realitetin. Ai u kujtoi lexuesve se Shqipëria ka hartuar një kuadër ligjor për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare dhe se Greqia historikisht e ka mohuar ekzistencën e një minoriteti shqiptar në Greqi. Megjithatë, duke lexuar [deklaratat](#) e Mitsotakis-it, duket se ai, në fakt, nuk e ka quajtur Himarën një bashki të minoritetit grek. Gjithashtu, ai tha se në kuadrin e një Shqipërie evropiane dhe “në frymën e bashkëpunimit dhe miqësisë me qeverinë shqiptare, të gjitha çështjet mund të zgjidhen”.

Nga ana tjetër, është një vlerësim i drejtë që asnjë qeveri greke nuk do të kishte lejuar ndonjëherë një vizitë të tillë të një kryeministri shqiptar në zonat kufitare të Greqisë, siç thotë Bushati.



3.6. KONKLUZIONE KRYESORE

- ↳ Kryeministri grek bëri dy vizita me rëndësi simbolike në Shqipëri në një hark kohor prej dy javësh. Mesazhi kryesor ishte se Greqia dhe Shqipëria shfaqin një vullnet të fortë për të ecur përpara dhe për të filluar një faqe të re në historinë e marrëdhënieve të tyre. Athina e sheh Tiranën si një portë prej ku Greqia të konsolidojë një rol më aktiv në Ballkan si dhe, njëherësh, të kundërbalancojë marrëdhëniet e Turqisë me Shqipërinë.
- ↳ Për të arritur të dy objektivat, Athina është angazhuar fort për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Është me rëndësi që fqinji i saj është një anëtar i NATO-s dhe krejtësisht në të njëjtën linjë me Perëndimin, ndërkaq, edhe minoriteti grek në Shqipëri, ashtu edhe komuniteti shqiptar në Greqi, fuqizojnë edhe më tej lidhjet e forta dypalëshe dhe interesat e përbashkëta. Dalja së bashku e të dy kryeministrave, shqiptar dhe grek, në fshatrat e minoritetit grek, përcjell pikërisht këtë mesazh të qartë.
- ↳ Megjithatë, edhe një herë mediat në të dy vendet humbën mundësinë për të nxjerrë në pah këtë realitet dhe për të dhënë një pasqyrë të balancuar të problemeve reale me të cilat përballet si minoriteti grek ashtu edhe ai shqiptar në Greqi. Ato gjithashtu nuk arritën të bëjnë një vlerësim largpamës për të ardhmen e marrëdhënieve në kontekstin e integritimit evropian.
- ↳ Është momenti kyç që të dy vendet të kapërcejnë përfundimisht problemet e trashëguara nga e kaluara, të cilat pengojnë konsolidimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe dhe pajtimin përfundimtar të dy popujve. Media mund të luajë një rol konstruktiv në përpjekje të tilla duke i dhënë më shumë hapësirë brezave të rinj të akademikëve dhe zërave të moderuar që mund të shpjegojnë realitetet aktuale në marrëdhëniet dypalëshe, arsyet pse disa çështje vazhdojnë të ekzistojnë dhe çfarë zgjidhjesh të drejta mund të aplikohen.

Ekipi

Drejtuues i projektit dhe koordinator akademik:

[Ioannis Armakolas](#)

Profesor i Asociuar, Universiteti i Maqedonisë; Bashkëpunëtor Shkencor & Shef i Programit të Evropës Juglindore, ELIAMEP

Analiste e medias & kryeredaktore e MORE:

[Alexandra Voudouri](#)

Gazetare, Studiuuese e Asociuar, Programi i Evropës Juglindore, ELIAMEP

Analist i medias dhe redaktor i MORE:

[Çelik Rrupli](#)

Studiues i Asociuar, Programi i Evropës Juglindore, ELIAMEP

Asistent kërkimor dhe redaktimi:

[Ioannis Paporizos](#)

Junior Research Fellow, Programi i Evropës Juglindore, ELIAMEP

Administrator:

[Alexandros Koutras](#)

Junior Research Fellow, Project Manager, Programi i Evropës Juglindore, ELIAMEP

Rreth këtij publikimi

Shënim i rëndësishëm: Të gjithë "artikujt e medias - imazhet" dhe lidhjet e përfshira në këtë Raport të Observatorit të Medias (MORE korrik 2023) janë indikative dhe përdoren ekskluzivisht si shembuj për hir të ekuilibrit dhe si dëshmi e gjetjeve dhe vlerësimeve tona cilësore kërkimore. Si projekt, MORE, nuk mund të konsiderohet në asnjë rrethanë si komercial. Përdorimi i paanshëm i artikujve të medias dhe lidhjeve ishte qëllimi ynë ekskluziv si analistë politikë në një organizatë jofitimprurëse.

Raporti i Observatorit të Medias (MORE) është pjesë e projektit shumëstresor **ALGREE — Shqipëri-Greqi: Kuptimi. Lidhja. Partneriteti.** zbatuar nga Programi i Evropës Juglindore të Fondacionit helen për Politikën e Jashtme dhe Evropiane (ELIAMEP), dhe i mundësuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë ([OSFA](#)) dhe Fondacioni Friedrich Naumann për Liri Greqi dhe Qipro ([ENF](#)).

Rreth [Programit Juglindor të ELIAMEP-it](#)

Rreth projektit [ALGREE — Shqipëri-Greqi: Kuptimi. Lidhja. Partneriteti.](#)

Rreth [Shih MORE – Raporti i Observatorit të Medias](#)

Email: algree_see@eliamep.gr

Na ndiqni në mediet sociale:

 facebook: [South-East Europe Programme/ ELIAMEP](#)

 twitter: [SEE Programme ELIAMEP](#)

Copyright © 2023 | All Rights Reserved
HELLENIC FOUNDATION FOR EUROPEAN AND FOREIGN POLICY (ELIAMEP)

*ELIAMEP inkurajon dialogun e hapur dhe, pluralist të bazuar në argumente dhe fakte.
Pikëpamjet e shprehura nga bashkëpunëtorët e ELIAMEP-it janë tërësisht të tyre dhe nuk janë të detyrueshme për Institucionin.*

ZBATUAR NGA

MUNDËSUAR NGA

eDizajni kreativ**Marie Claire I. Androulaki**PR/Marketing Communications Consultant
& Creative eDesigner, MAKES SENSE

M	A	K	E	S
S	E	N	S	E

Ilustrimet/Të drejtat e fotove & E drejta e autorit- Leja për përdorim

Ilustrime/Të drejta autori për foto nga media të ndryshme, banka imazhi dhe platforma kreative:©Dreamstime.com,** ©Envato elements,** ©Canva**

Çdo artikull (ilustrim, foto) i përfshirë në këtë Raport nuk duhet të nxirret ose përdoret veçmas nga ky produkt përfundimtar. Këto artikuj nuk janë pronësi e ELIAMEP apo MAKES SENSE. As ELIAMEP dhe as MAKES SENSE nuk zotërojnë të drejtën e autorit në lidhje me të gjitha logot, ilustrimet dhe fotot e palëve të treta nga media të ndryshme, banka imazhesh ose platforma (siç u përmend më lart) që shfaqen në të gjitha faqet -- me përjashtim të ilustrimit të faqes së kopertinës (si e tërë). Për çdo përdorim ose riprodhim të elementeve që nuk janë në pronësi të ELIAMEP ose MAKES SENSE, leje-licenca duhet të kërkohet drejtpërdrejt nga mbajtësit përkatës të këtyre të drejtave.

** Përpunime/rregullime të mëtejshme, përshtatja ose dizajni kreativ i ilustrimeve - fotove nga MAKES SENSE



ΕΛΛΗΝΙΚΟ ΙΔΡΥΜΑ ΕΥΡΩΠΑΪΚΗΣ & ΕΞΩΤΕΡΙΚΗΣ ΠΟΛΙΤΙΚΗΣ
HELLENIC FOUNDATION FOR EUROPEAN & FOREIGN POLICY

Copyright © 2023 | All Rights Reserved

HELLENIC FOUNDATION FOR EUROPEAN AND FOREIGN POLICY (ELIAMEP)

Vasilissis Sofias Ave., 49
10676 Athinë, Greqi
Tel: +30 210 7257 110

[Programi i Evropës Juglindore, ELIAMEP](#)

Projekti [ALGREE — Shqipëri-Greqi: Kuptimi. Lidhja. Partneriteti.](#)
algree_see@eliamep.gr